



## COMUNE DI RAVENNA

Area Servizi e Partecipazione dei Cittadini

U.O. Politiche per l'Immigrazione e Cooperazione Decentrata

Centro Immigrati

Via Oriani 44, tel 0544/485314

### **KANË TË DREJTË TË KËRKOJNË NËNSHTETËSINË ITALIANE:**

**QYTETARËT EXTRA UE QË KANË 10 VITE ME VENDBANIM NË ITALI;**

**QYTETARËT E BASHKIMIT EVROPIAN QË KANË 4 VJET VENDBANIM;**

**REFUGJATËT POLITIKË QË KANË 5 VITE VENDBANIM;**

**QYTETARËT E HUAJ QË KANË KONTRATË MARTESE ME NJË QYTETAR ITALIAN DHE QË BANOJNË NË MËNYRË TË RREGULLT PREJ TË PAKTËN 2 VITESH QË NGA CELEBRIMI I MARTESES**

*(Nëse bashkëshortët jetojnë jashtë vendit, kërkesa mund të prezantohet pas 3 vitesh që nga data e martesës, afate të cilat përgjysmohen nëse bashkëshortët kanë fëmijë të lindur apo të birësuar bashkë.)*

### **LISTA E DOKUMENTAVE**

#### **LISTA E DOKUMENTAVE QË I BASHKANGJITET KËRKESËS PËR NËNSHTETËSINË ITALIANE**

- 1) ***Çertifikatë e lindjes në Vendin e origjinës , e plotësuar me gjithë të dhënat përkatëse\*;***
- 2) ***Dëshmi e penaliteti e Vendit të origjinës dhe të Vendeve të treta ku ka jetuar ; \****  
*( ka afat 6 mujor nga data e lëshimit )*
- 3) ***Të ardhurat vjetore (CUD, UNICO, 730) bashkëlidhur me të ardhurat e tre viteve të fundit; (kërkohet një shumë e caktuar, e cila i nënshtrohet ndryshimit).***  
***Për Punëtorët Shtëpiakë është e nevojshme një Deklaratë e të Ardhurave;***
- 4) ***Leja e qëndrimit;***
- 5) ***Pasaporta;***
- 6) ***Karta e identitetit italian;***
- 7) ***Dëshmi e njohjes së nivelit B1 të gjuhës italiane,***  
***SHTETAS UE: e nevojshme dëshmia e njohjes së gjuhës italiane, e nivelit B1;***  
***SHTETAS EXTRA-UE: vetëm nëse zotëron lejen e qëndrimit me kohëzgjatje të gjatë(leja e qëndrimit e vjetër) NUK ËSHTË E NEVOJSHME.;***
- 8) ***Lista e vendbanimeve që ka patur në Itali dhe jashtë;***
- 9) ***Kontribut prej € 250,00 përmes pagesës online PagoPA (Sistemi i Administratës Publike)***
- 10) ***Pullë tatimore prej 16€;***
- 11) ***Të jenë të pajisur me SPID.***

**\*Dokumentat e pikave të 1) dhe të 2) duhet të jenë të legalizuara nga Autoriteti Diplomatik ose Konsullor Italian i pranishëm në Shtetin nga vjen, me përjashtim të parashikimeve për Shtetet palë në Konventat Ndërkombëtare. Aktet po ashtu duhet të jenë të përkthyer siç duhet në gjuhën italiane nga Autoriteti i**

lartpërmendur ose , në Itali, nga Autoriteti diplomatike ose Konsullata e Vendit që ka lëshuar dokumentin (në këtë rast nevojitet firma e oficerit të huaj , duhet të legalizohet nga Prefektura kompetente), apo nga një përkthyes zyrtar ose nga një përkthyes që e vërteton, me formalitet e kërkuara pajtueshmërinë me tekstin e huaj.

**LISTA E DOKUMENTAVE QË I BASHKANGJITET KËRKESËS  
NË RASTIN E MARTESËS ME SHTETAS ITALIAN**

- 1) **Çertifikatë e lindjes në Vendin e origjinës , i plotësuar me gjithë të dhënat përkatëse\*;**
- 2) **Dëshmi penaliteti e Vendit të origjinës dhe të Vendeve të treta ku ka jetuar; \* ( ka afat 6 muaj nga data e lëshimit )**
- 3) **Çertifikata e martesës (nëse është e huaj e përkthyer dhe e legalizuar );**
- 4) **Leja e qëndrimit;**
- 5) **Pasaporta;**
- 6) **Karta e identitetit italiane;**
- 7) **Dëshmi e njohjes së nivelit B1 të gjuhës italiane,**  
**SHTETAS UE: e nevojshme dëshmia e njohjes së gjuhës italiane, e nivelit B1;**  
**SHTETAS EXTRA-UE: vetëm nëse zotëron lejen e qëndrimit me kohëzgjatje të gjatë(leja e qëndrimit e vjetër) NUK ËSHTË E NEVOJSHME.;**
- 8) Lista e vendbanimeve të patura në Itali dhe jashtë;
- 9) **Kontribut prej € 250,00 përmes pagesës online PagoPA (Sistemi i Administratës Publike)**
- 10) **Pullë tatimore prej 16€;**
- 11) **Të jeni të pajisur me SPID**

(Në momentin e miratimit të dekretit për dhënien e nënshtetësisë, nuk duhet të ketë patur asnjë shpërbërje, anulim ose shuarje të efekteve civile të martesës dhe nuk duhet të ketë ndarje personale të bashkëshorteve.

Nga data 18/06/2015 Ministria e Brendshme ka parashikuar , që kërkesa për Nënshtetësi të mund të prezantohet në mënyrë telematike, kështu që të gjithë qytetarët mund të plotësojnë kërkesën, duke përdorur SPIDIN dhe duke u lidhur me linkun e mëposhtëm <https://portaleservizi.dlci.interno.it/>

**Për t'iu drejtuar Qendrës së Emigrantëve është e nevojshme:**

**Të fiksoni një takim duke telefonuar në numrin 0544-485314 ose 329-9079549**  
**Ditë e martë dhe të enjte nga ora 09:00 deri në 13:00**

**Nuk do priten dhe ndihmohen në plotësimin e kërkesave, personat që nuk kanë caktuar takim ose që nuk zotërojnë dokumentacionin e plotë.**

Ju kujtojmë që administrata komunale e cila nuk është e përgjegjshme për rezultatin e procedurës administrative në dhënien e Nënshetësisë, kjo e fundit është kompetencë ekskluzive juridike e Ministrisë së Brendshme, e përfaqësuar në territor nga Prefektura, përsa kohë ofron vetëm një shërbim asistence në përpilim.

PËRDITËSIMET E FUNDIT ME DATË 22/02/2023